



REZOLUTA I

Rrethi i Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i mbledhur më 28 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

vendos me shumicë prej dy të tretash të 32 anëtarëve të pranishëm

të miratojë projekt – axhendën e përgatitur në përputhje me nenin 8 të Statutit dhe nenin 10 të Rregullores së Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, siç është përcjellë në tërësi të të gjitha gjykatat anëtare të kësaj organizate, me përjashtim të një ndryshimi të vogël në pikën II.3, e cila do të formulohet si më poshtë:

*II.3: Diskutimi dhe miratimi **i mundshëm** i kërkesës për anëtarësim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.*

Tiranë, më 28 shkurt 2025

Holta Zaçaj
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë



REZOLUTA II

Rrethi i Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i mbledhur më 28 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

Duke marrë parasysh kërkesën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për t'u pranuar si anëtare me të drejta të plota në Konferencën e Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

Pasi dëgjoi fjalimin e z. Nexhmi Rexhepi, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,

Pasi dëgjoi prezantimin e raportit të komitetit të ngritur në bazë të Rezolutës III të Rrethit të Kryetarëve (22 maj 2024, Kishinau), nga znj. Holta Zaçaj,

Duke marrë parasysh mendimet miratuese të pjesëmarrësve në Mbledhjen Përgatitore,

vendos me shumicë prej dy të tretash të 32 anëtarëve të pranishëm

të pranojë Gjykatën Kushtetuese të Kosovës si anëtare me të drejta të plota në Konferencën e Gjykatave Kushtetuese Evropiane.

Tiranë, më 28 shkurt 2025

Holta Zaçaj

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë



REZOLUTA III

Rrethi i Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i mbledhur më 28 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

vendos unanimit

Që tema e Kongresit të XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane do të jetë: ***Liria e Shprehjes dhe Lajmet e Rreme si Kërcënime ndaj Demokracisë.***

Tiranë, më 28 shkurt 2025

Holta Zaçaj

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë



REZOLUTA IV

Rrethi i Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i mbledhur më 28 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

vendos me shumicë prej dy të tretash të 32 anëtarëve të pranishëm

të miratojë disa çështje organizative që lidhen me përgatitjen e Kongresit të XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, në përputhje me nenin 9, pika 2 të Statutit, si më poshtë:

1. Kongresi i XX-të i Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane do të zhvillohet në Tiranë, nga data 3 deri më 5 maj 2027 (*neni 9, pika 2, shkronja (c) dhe neni 9, pika 5 e Statutit*).
2. Përveç rasteve kur ndonjë nga gjykatat anëtare kërkon sigurimin e përkthimit në një gjuhë tjetër në përputhje me Statutin, gjuhët e Kongresit të XX-të do të jenë frëngjisht, anglisht, gjermanisht dhe shqip (*neni 9, pika 2, shkronja (c) e Statutit; neni 12 i Rregullores së Konferencës*).
3. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë do të përgatisë dhe do të shpërndajë një pyetësor për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane. Pyetësori do t'u dërgohet gjykatave anëtare për komente deri në tetor 2025. Gjykatat anëtare do të duhet t'i dërgojnë komentet deri në dhjetor 2025. Pas përfshirjes së komenteve, versioni përfundimtar i pyetësorit do t'u shpërndahet gjykatave anëtare për plotësim, jo më vonë se shkurti 2026. Pyetësorët e plotësuar duhet t'i kthehen Sekretariatit të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane deri në dhjetor 2026. Materiali duhet të dërgohet si në

gjuhën kombëtare të gjykatës anëtare, ashtu edhe në anglisht ose frëngjisht (neni 3 i Rregullores së Konferencës).

4. Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Marsida Xhaferllari, caktohet Relatore e Përgjithshme e Kongresit të XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (*neni 3 i Rregullores së Konferencës*).
5. Kongresi i XX-të i Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane do të organizohet në sesione që do të pasohen nga diskutime plenare.
6. Personat dhe institucionet e renditura në aneksin e kësaj rezolute do të ftohen si vëzhgues dhe të ftuar në Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (*neni 9, pika 2, shkronja (b) e Statutit; neni 5, pika 1 dhe 2 e Rregullores së Konferencës*).
7. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës ftohet të bashkëpunojë në përgatitjen e Kongresit të XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane. Komisioni i Venecias do të përgatisë një Buletin të posaçëm për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane.

Aneks: Lista e Vëzhguesve dhe të Ftuarve për Kongresin e XX-të të CECC.

Tiranë, më 28 shkurt 2025

Holta Zaçaj

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë



LISTA E VËZHguesVE DHE TË FTUARVE NË KONGRESIN E XX-të

Në përputhje me nenin 9, pika 2, shkronja (b) të Statutit dhe nenin 5, pika 1 të Rregullores së Konferencës, propozohet që personat dhe institucionet e mëposhtme të ftohen si vëzhgues në Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane:

- Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjyqtari i kësaj Gjykate i zgjedhur për Republikën e Shqipërisë;
- Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian;
- Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare Penale;
- Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë;
- Kryetari i Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias);
- Kongresi Botëror për Drejtësinë Kushtetuese (WCCJ);
- Forumi i Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit (BCCF);
- Rrjeti Global për Drejtësinë Zgjedhore;
- Shoqata e Gjykatave Kushtetuese dhe Institucioneve Ekuivalente të Azisë (AACC);
- Shoqata e Gjykatave Kushtetuese Frankofone (ACCF);
- Gjykatat e *Commonwealth*;
- Konferenca e Organeve të Kontrollit Kushtetues të Vendeve me Demokraci të Re;
- Konferenca e Juridiksioneve Kushtetuese të Vendeve Portugalishtfolëse;
- Konferenca e Juridiksioneve Kushtetuese të Afrikës (CJCA);
- Konferenca Ibero-Amerikane e Drejtësisë Kushtetuese;
- Forumi i Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese të Afrikës së Jugut;
- Unioni i Gjykatave dhe Këshillave Kushtetuese Arabe;

- Kryetarët e gjykatave kushtetuese dhe institucioneve ekuivalente që janë aktualisht në proces aplikimi për anëtarësim në CECC.

Po kështu, në përputhje me nenin 9, pika 2, shkronja (b) të Statutit dhe nenin 5, pika 2 të Rregullores së Konferencës, propozohet që personat e mëposhtëm të ftohen si të ftuar në Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane:

- Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- Kryeministri i Republikës së Shqipërisë;
- Ish-gjyqtarë të nderuar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë;
- Përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë;
- Përfaqësues të institucioneve të drejtësisë të Republikës së Shqipërisë;
- Profesorë të spikatur në fushën e së drejtës dhe personalitete të respektuara të botës akademike shqiptare.



REZOLUTA V

Rrethi i Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i mbledhur më 28 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

vendos unanimit

të miratojë shpenzimet e përgjithshme që lidhen me organizimin e Mbledhjes Përgatitore të Rrethit të Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, e cila u zhvillua në Tiranë më 28 shkurt 2025. Këto shpenzime do të shpërndahen në mënyrë proporcionale (pro rata) midis gjykatave anëtare me të drejta të plota të Konferencës që morën pjesë në mbledhjen e Rrethit të Kryetarëve, sipas numrit të anëtarëve për secilin delegacion.

Të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me mbledhjen e Rrethit të Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, e cila u zhvillua në Tiranë, në datën 28 shkurt 2025, si dhe shpenzimet për programin shoqëruar, do të përballohen nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë do t'i paraqesë të gjitha gjykatave anëtare buxhetin paraprak të Kongresit të XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane deri në prill 2026.

Tiranë, më 28 shkurt 2025

Holta Zaçaj

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë



REZOLUTA VI

Rrethi i Kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i mbledhur më 28 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për Kongresin e XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane,

Duke marrë parasysh diskutimet dhe propozimet e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhjen e Rrethit të Kryetarëve për çështjen që lidhet me hartimin e një Buletini Periodik me Tema Kyçe të CECC-së,

vendos unanimit

Ngritjen e një komiteti i cili do të shqyrtojë burimet e disponueshme, duke përfshirë bazat e të dhënave ekzistuese si CODICIES dhe rrjeti hungarez, me qëllim përcaktimin e mënyrës se si ato mund të integrohen ose të lidhen për të krijuar një mjet kërkimi të unifikuar. Komiteti do të eksplorojë mënyrat e zbatimit të kësaj ideje në përputhje me kapacitetet e të gjitha gjykatave pjesëmarrëse.

Komiteti do të adresojë po ashtu aspektet teknike dhe praktike të këtij propozimi, si përcaktimi i temave që do të përfshihen dhe mënyra e përzgjedhjes së vendimeve që do të përfshihen. Komiteti do t'i paraqesë gjetjet e tij në mbledhjen e ardhshme, duke ndihmuar në vendimmarrjen për vijimin ose jo të kësaj nisme në tërësi.

Tiranë, më 28 shkurt 2025

Holta Zaçaj

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë